



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE
KOMISIONI I PROVIMEVE TË AFTËSIVE PROFESIONALE**

**Zbatimi i modeleve të duhura të organizimit, drejtimit, qeverisjes dhe kontrollit të brendshëm të njësive ekonomike të biznesit (personave juridikë);
Përdorimi i sistemeve të informacionit dhe të informatikës**

8 Dhjetor 2018

Seksioni I

**Pyetje me alternativa (1 pikësecila).
Zgjidhni alternativën e saktë.**

1. Cili nga elementet e mëposhtëm nuk është e përfshirë në marrëveshjen e themelimit të një ortakërie?
 - a) Obligimet e secilit partner;
 - b) Taksat që do të paguhën;**
 - c) Pagat dhe llogaritë rrjedhëse të secilit partner;
 - d) Dispozita për ndarjen e fitimeve dhe humbjeve.

Përgjigja e saktë është alternativa (B)

2. Cilat nga konceptimet më poshtë nuk mund të përfaqësojë drejt etikën e biznesit?
 - a) Etika e biznesit paraqet rregulla, standarde, kode, apo parime të cilat ofrojnë udhëzime për sjellje moralisht të drejta dhe të vërteta në situata të caktuara;
 - b) Etika e biznesit është një studim i situatës së biznesit, aktiviteteve dhe vendimeve ku janë trajtuar çështjet se çka është e drejtë dhe e gabuar;
 - c) Etika e biznesit i referohet standardeve dhe normave të qarta që ndihmojnë punonjësit për të dalluar sjelljen e drejtë nga ajo e gabuar në punë;
 - d) Etika e biznesit janë standardet e sjelljes së punonjëseve me eprorët e tyre dhe vendimet që këta të fundit ndërmarrin për promovimet respektive.**

Përgjigja e saktë është alternativa (D)

3. Cili nga shembujt e mëposhtëm plotëson kriteret për t'u konsideruar si një gjykim normativ?

- a) **Pasqyrat tuaja janë përgatitur me shifra të gabuara;**
- b) Shifrat tuaja nuk rakordojnë me shifrat që zotëron audituesi i shoqërisë;
- c) Asnjëra;
- d) Të dyja.

Përgjigja e saktë është alternativa (A)

4. SNA 315 trajton përgjegjësinë e audituesit për të identifikuar dhe vlerësuar rreziqet e anomalive material në pasqyrat financiare përmes njohjes së entitetit dhe mjedisit të tij, duke përfshirë pesë komponentët e kontrollit të brendshëm të entitetit. Cili nga elementët e mëposhtëm nuk është përcaktuar si një komponent i kontrollit të brendshëm brenda SNA 315?

- a) Mjedi i kontrollit;
- b) Sistemi informativ i rëndësishëm për raportimin financiar;
- c) Procesi i vlerësimit të rrezikut të entitetit;
- d) **Politikat dhe praktikat e burimeve njerëzore.**

Përgjigja e saktë është alternativa (D)

5. Elementë të kontrollit manual mund të jenë më të përshtatshëm në rrethanat e mëposhtme:

- a) Volum i lartë i transaksioneve rrjedhëse;
- b) **Volum i ulët i transaksioneve;**
- c) Aktivitete të kontrollit ku mënyra specifike të kontrollit mund të dizajnohen në mënyrë të përshtatshme dhe automatike;
- d) Situata ku gabimet mund të parashikohen, paraprihen, apo kapen e korrigjohen nga parametrat e kontrollit që janë automatike.

Përgjigja e saktë është alternativa (B)

6. Aktivitetet e kontrollit:

- a) Nuk ndihmojnë për të siguruar që direktivat e menaxhimit janë zbatuar;
- b) **Janë politika dhe procedura;**
- c) Nuk kanë të bëjnë me objektivat;
- d) Nuk janë të aplikuara në disa nivele funksionesh.

Përgjigja e saktë është alternativa (B)

7. Sipas, _____ mekanizmat e jashtëm edhe të brendshëm të qëverisjes së korporatave, synojnë të nxisin manaxherët për të kryer veprime që maksimizojnë fitimet dhe vlerën e aksionarëve.

- a) Teorisë së aksionarëve;
- b) Teorisë së agjensisë;
- c) Teorisë së grupit të interesit;
- d) Teorisë së qeverisjes së korporatave.

Përgjigja e saktë është alternativa (A)

8. Matrica e Mendelow jep lidhjen mes:

- a) Interesit dhe influencës;
- b) Interesit dhe fuqisë;
- c) Influencës dhe fuqisë;
- d) Asnjë nga të mësipërmet.

Përgjigja e saktë është alternativa (B)

9. Është detyrë e Bordit të Drejtorëve:

- a) Manaxhimi i konflikteve të mundshme të interesit;
- b) Monitorimi i rreziqeve, sistemeve të kontrollit dhe qeverisjes;
- c) Të dy alternativat më sipër;
- d) Asnjë nga alternativat.

Përgjigja e saktë është alternativa (C)

10. Çfarë janë të dhënat?

- a) Fakte të papërpunuara që përshkruajnë karakteristikat e një ngjarjeje ose objekti;
- b) Të dhëna të konvertuara në një kontekst kuptimplotë dhe të dobishëm;
- c) Informacioni mbledhur nga disa burime, që analizon modele, tendenca dhe relacione për vendimmarrje strategjike;
- d) Aftësitë, eksperiencia dhe ekspertiza, të shoqëruara me informacion dhe inteligjencë, të cilat krijojnë burimet intelektuale të një personi.

Përgjigja e saktë është alternativa (A)

Parimet bazë të organizimit dhe administrimit të entiteteve të biznesit

- 11.** Cilat janë dallimet kryesore ndërmjet modelit ekonomik dhe socio-ekonomik të përgjegjësisë sociale?

5 pikë

Përgjigje:

Përgjegjësia sociale ka të bëjë me obligimin ndaj shoqërisë në të cilën vepron një biznes; detyrimi i organizatës së biznesit për të përcaktuar ato politika, për të marrë ato vendime e veprime që janë njëkohësisht në përputhje me interesat e saj dhe objektivat e shoqërisë.

Modeli ekonomik i përgjegjësisë sociale për organizatat: Të prodhojnë Pr/Sh cilësore për të cilat ka nevojë shoqëria; Të arrijnë një nivel fitimi të pranueshëm e të ofrojnë vende pune.

Modeli socio-ekonomik i përgjegjësisë sociale për organizatat: Korporata është krijim i shoqërisë; Nëse nuk vepron si qytetar i mirë, shoqëria kërkon ndryshime; Është më mirë të tregojnë vetë interes, sesa të bëhen objekt i veprimeve ligjore nga grupe sociale.

Më të përmbledhura, dallimet jepen si vijon:

Modeli ekonomik	Modeli socio-ekonomik i përgj. sociale
Theksi vihet në: 1. Prodhim 2. Shfrytëzimin e burimeve natyrore 3. Vendime të brendshme të orientuara nga tregu 4. Bazimi në fitimin 5. Interesin e firmës apo menaxherit 6. Rolin e vogël të qeverisë	Theksi vihet në: 1. Cilësinë e jetës 2. Ruajtjen e burimeve natyrore 3. Vendime të orientuara nga tregu me një farë kontrolli nga komuniteti 4. Balancimin e aspektit ekonomik dhe social 5. Interesin e firmës dhe komunitetit 6. Angazhimin aktiv të qeverisë

- 12.** Tregoni avantazhet dhe disavantazhet e vendimarrjes në grup. Konkretizojeni me një shembull.

5 pikë

Përgjigje:

Natyra e problemeve dhe madhësia e ndikimit të vendimeve përcaktojnë në një masë të konsiderueshme nëse menaxherët do t'i marrin vendimet individualisht, pra në mënyrë autoritare, apo në grup duke përdorur sistemin e pjesëmarrjes. Shembull

Avantazhet dhe disavantazhet e vendimarrjes në grup në mënyrë të përmbledhur:

Nr	AVANTAZHET	DISAVANTAZHET
1	Informacion më i madh që zotërohet nga grupi sesa nga një individ i vetëm.	Kërkon kohë (të gjithë anëtarët e grupit duan të diskutojnë).
2	Numër më i madh alternativash.	Dominim potencial nga një individ apo grup.
3	Shkëmbim eksperience ngaqë numër i madh anëtarësh grupi.	Përpyqje për të evituar konfliktin (ruajtja e marrëdhënieve të mira).
4	Shkallë e lartë pranueshmërie nga grupi.	Kur grupe të mëdha, vendim-marrja bëhet e vështirë (varet nga përbërja, numri dhe karakteristikat e secilit individ).
5	Sipërmarrje më e lartë risku nga grupi.	

13. Përshkruani shkurtimisht llojet (fazat) e kontrollit në organizatë. Si duhet të jetë përqëndrimi nga organizata te secili kontroll (fazë) dhe efektet që vijnë nga mos ushtrimi i kontrollit apo ushtrimi i mirë i kontrollit tek organizata.

5 pikë

Përgjigje:

Kontrolli është funksion i çdo menaxheri, që nga presidenti i kompanisë e deri tek menaxheri më i ulët. Fusha dhe përgjegjësia e kontrollit të secilit është në varësi të pozitës që ata zënë në piramidën menaxheriale.

Llojet e kontrollit në organizatë sipas fazave të prodhimit të një produkti apo krijimit të një shërbimi janë:

- **Kontrolli paraprak**, ku fusha e këtij kontrolli janë burimet fizike, njerëzore, financiare dhe informative që hyjnë në organizatën e biznesit nga mjedisi i jashtëm.
- **Kontrolli i ndërmjetëm**, i cili ka në qendër të tij proceset e transformimit, aktivitetet që kryhen gjatë shndërrimit të materialeve në produkte të gatshme, kontroll i cili realizohet kryesisht nëpërmjet aktiviteteve mbikqyrëse të menaxherëve.
- **Kontrolli përfundimtar**, i cili zakonisht merret me sasinë dhe cilësinë e produkteve të prodhuara (outputet), pasi ka përfunduar ciklin e prodhimit të tyre; dhe ndryshe quhet kontrolli feedback.

E mira është që të bëhet kontroll në çdo fazë; nëse kontroll 100%, siguron saktësi në vlerësim, por ka kosto, prandaj sugjerohet përdorimi i mostrave. Përqëndrimi i kontrollit në çdo fazë prodhimi/krijimi produkti apo shërbimi varet nga politika

e kompanisë dhe buxheti që do t'i akordohet kontrollit. Sa më shumë kontroll, aq më mirë.

Nëse ushtrohet pak kontroll paraprak apo i ndërmjetëm apo final, kjo do sjellë ulje të shpenzimeve të kontrollit, por mund të sjellë rritje potenciale të produkteve me defekte dhe rënie të shitjeve në të ardhmen; dhe e kundërta: sa më shumë kontroll (sugjerohet përdorimi i mostrave) në çdo fazë: paraprake, të ndërmjetme apo përfundimtare, mund të sjellë kosto kontrolli, por do të sjellë ulje të produkteve me defekte, rritje të shitjeve, rritje të fitimeve, pra përmirësim i situatës së biznesit për kompaninë.

- 14. Përshkruani karakteristikat e ortakërive. Jepni 3 përparësi dhe problematika që lidhen me këtë formë pronësie biznesi?**

6 pikë

Përgjigje:

Ortakëria është një formë ligjore e biznesit me dy ose më shumë pronarë.

Përparësitë e Ortakërive:

Ekzistenca e një apo më shumë partnerëve në biznes sjell shumë përparësi. Shpeshherë është shumë më e lehtë të zotërohet dhe menaxhohet një biznes me një apo më shumë pronar. Pronari juaj mund t'ju zëvendësojë kur ju jeni sëmurë apo ikni me pushime.

1. Më shumë resurse financiare – kur dy ose më shumë njerëz i mbledhin bashkë paratë dhe kreditë e tyre është më e lehtë të paguhet qiraja, shërbimet publike dhe faturat e tjera të biznesit. Një ortakëri e ndihmon në rritjen e kapitalit.
2. Përgjegjësitë e ndara në menaxhim dhe bashkimi njohurive – është më e lehtë të menaxhohen aktivitetet e përditshme të një biznesi me partnerë të zgjedhur me kujdes. Partnerët i japin njëri tjetrit kohë të lirë nga biznesi dhe ofrojnë njohuri dhe perspektiva të ndryshme.
3. Jetëgjatësia më e madhe- pasja e një partneri mund të asistojë një biznesmen apo profesionin e lire me disiplinën e nevojshme për të siguruar një jetëgjatësi më të madhe të biznesit.

Disavantazhet e Ortakërive

1. Përgjegjësitë e pakufizuara – secili ortak i përgjithshëm është përgjegjës për borxhet e kompanisë pa marrë parasysh se kush ishte fajtor për shkaktimin e këtyre borxheve. Ti je përgjegjës për gabimet e partnerit, njësoj si për gabimet e tua. Shumë shtete tashmë po lejojnë krijimin e ortakërive me përgjegjësi të kufizuara në mënyrë që ky disavantazh të mos ekzistojë më.
2. Ndarja e fitimeve – ndarja e rrezikut do të thotë dhe ndarja e fitimit, dhe kjo mund të krijojë konflikte midis partnereve. Secili mund të mendojë se i takon një pjesë më e madhe e fitimit si pasojë e punës që kryen.
3. Vështirësitë për të mbyllur biznesin – në momentin që dikush angazhohet në një ortakëri nuk është aq e thjeshtë të largoheni sic do të ishte me biznesin individual. Në momentin e largimit nga ortakëria lindin problematikat e ndarjes së aktiveve si dhe zbatimi i saktë i marrëveshjeve që janë nënshkruar.

15. Cilat janë pengesat që mund të lindin gjatë qeverisjes së një Korporate si pasojë e vendosjes së sistemeve të brendshme.

6 pikë

Përgjigje:

Kontrolli i brendshëm është ndërtues i vazhdueshëm i operacioneve e procedurave i kryer nga njerëzit dhe që jep siguri të arsyeshme për menaxhimin se objektivat po arrihen. Kontrolli i brendshëm është pjesë integrale e cdo sistemi që menaxhimi përdor për të rregulluar dhe drejtuar veprimet brenda organizatës.

Pengesat që shkaktohen si pasojë e vendosjes së sistemeve të brendshme mund të përfshijnë:

1. Keqkuptimi i instruksioneve, rregullave dhe procedurave – është një kufizim tipik që ndikon vlerat e kontrollit të brendshëm. Në mënyrë që instruksionet të zbatohen sic duhet është e rëndësishme që të jenë kuptuar nga personeli që merret me zbatimin e tyre.
2. Gjykimet e papërshtatshme dhe gabimet njerëzore – arritja e objektivave përfshin një proces kompleks ku ndërthuren shumë faktore që kanë ndikime të ndryshme në rezultatet që kërkohen të arrihen. Menaxhimi kërkon një vendimmarrje në përputhje me kushtet konkrete, me njohjen e gjendjes dhe të faktorëve që ndikojnë rezultatet dhe të bërë në kohën e duhur. Megjithatë në jetën e përditshme nuk ndodh gjithmonë që një vendimmarrje të marrë parasysht të gjithë rrethanat, cka con edhe në gjykime dhe opinione të gabuara që ulin efektivitetin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.
3. Pakujdesia personale – njerëzit kanë një rol shumë vendimtar në zbatimin e kontrollit të brendshëm sikurse dhe kontrollet mbartin pengesa të rëndësishme për realizim të tyre. Një sistem i kontrollit të brendshëm mund të të dështojë nga pakujdesia e individëve gjatë zbatimit të procedurave.
4. Aftësia apo mundësia për të mënjeluar shkeljet e bëra nga menaxhimi – drejtuesit e organizatës, nisur nga autoriteti që ka mund të anashkalojë disa nga politikat, procedurat apo kontrollet e brendshme, për qëllime të përfitimeve personale, të një paraqitjeje të përmirësuar të situatës financiare të organizatës, apo në funksion të deklarimit për statusin e respektimit të ligjeve e rregullave.

Qeverisja e Shoqërive tregtare, Roli i kodeve të mirëqeverisjes

16. Politikat e shtetit A po inkurajojnë investimet e huaja në fushën e kërkimit të hidrokarbureve në vendin e tyre. Shoqëria AB është një shoqëri lokale/kombëtare dhe zotërohet 100% nga një familje vendase. Administrimi i shoqërisë AB kryhet nga palë të treta, që nuk janë pronarë. Performanca e shoqërisë ka qënë e kënaqshme dhe personat përgjegjës për drejtimin e shoqërisë AB përfitojnë bonus në varësi të performancës vjetore të shoqërisë AB. Niveli i pagave në vendin A është i ulët dhe punonjësit kryesisht janë paguar me paga afër limitit minimal, në mënyrë që të maksimizohen fitimet dhe personat përgjegjës për drejtimin të përfitojnë bonuset. Për shkak të nivelit të ulët të pagave, shoqëria AB kapatur lëvizje të shumta të stafit. Politikae vendit A ka premtuar për të rritur pagat dhe për të përmirësuar legjislacionin e punës në përgjithësi, duke i ndaluar shoqëritë që të vendosin kushte të pafavorshme punë për punonjësit e tyre. Gjithashtu, është garantuar se shteti A do të ketë kontroll rigorozndaj respektimit të rregullave për mbrojtjen e natyrës nga ana e shoqërive të kërkimit. Së fundmi, një shoqëri e huaj ka shprehur interesin për të investuar në vendin A dhe ka kryer disa bisedime me zotëruesit e shoqërisë AB për të blerë shoqërinë. Ky investitor ka shprehur një kërkueshmëri të lartë ndaj punonjësve të tyre duke vendosur orare të zgjatura pune dhe nuk ka historik të qartë në respektimin e rregllave për mbrojtjen e ambjentit. Ligji vendas nuk i mbron punonjësit në rast të shitjes së biznesit dhe kontratat e tyre mund të ndërpriten duke favorizuar punëdhënësin.

Organizatave të mbrojtjes së mjedisit edhe pse janë të formuara, nuk kanë praktikë të ushtrimit të kompetencave të tyre dhe janë të tërhequra nga misioni i krijimit të tyre. Duke përdorur matricën Mendelow, analizoni rëndësinë e grupe vetë interesit më poshtë, në lidhje me vendimin për të ndryshuar kushtet e punësimit pas shitjes së shoqërisë AB tek investitori i huaj që ka shprehur interes për blerje.

- a- Personat engarkuar meqeverisjen e shoqërisë AB- 1 pikë
- b- Pronarëve të shoqërisë AB- 2pikë
- c- Punonjësve- 1pikë
- d- Organizatave të mbrojtjes së mjedisit- 1pikë

5 pikë

Përgjigje:

(Cdo trajtim i përgjithshëm i përgjigjes vlerësohet me 0 (zero) pikë, pasi kërkesa kërkon përgjigje vetëm në lidhje me vendimin për të ndryshuar kushtet e punësimit pas shitjes së shoqërisë AB).

Matrica Mendelow për grupet e interesit kërkohet të vlerësohet vetëm për vendimin për të ndryshuar kushtet e punësimit pas shitjes së shoqërisë AB tek investitori i huaj.

a- **Personat e ngarkuar me qeverisjen e shoqërisë AB:**

Interesi: I lartë, duke qënë se ky vendim do të ndikojë dhe mund të ketë efekt të rëndësishëm në paketën e shpërblimet të këtyre personave.

Fuqia: E ulët, edhe pse politikat e vendit A kanë tendencën për të qënë në favor të punëmarrësve, sidoqoftë kjo nuk e limiton investitorin e huaj për të ndryshuar kushtet kontraktuale me punonjësit, përfshirë personat e ngarkuar me qeverisjen. Gjithashtu personat e ngarkuar me qeverisjen mund të tërhiqen nga pozicioni i tyre.

b- **Pronarët e shoqërisë AB:**

Interesi: I ulët, pasi pronarët nuk merren me administrimin e shoqërisë AB. Interesi i tyre është vetëm nëse do të marrin dividend apo të shesin kuotat/aksionet dhe të marrin fitime kapitale nga shitja e investimit të tyre.

Fuqia: E lartë, pasi nëse oferta për të shitur kuotat/ aksionet e tyre është e kënaqshme për ta dhe ata i shesin kuotat/ aksionet, investitori i ri mund të vendos masa të pafavorshme nga punonjësve.

c- **Punonjësit:**

Interesi: I ulët marrë parasysh që shoqëria AB ka patur lëvizje të shumta të stafit. Kjo tregon se punonjësit nuk janë të lidhur me shoqërinë për shkak të pagave minimale, pra kushtet për punëmarrësit vlerësohen të pafavorshme që pa u ndryshuar pronësia.

Fuqia: E ulët, pasi punonjësit e larguar janë zëvendësuar gjithmonë.

d- **Organizatat e mbrojtjes së mjedisit:**

Interesi: I ulët ose nuk ekziston, pasi çështja për tu vlerësuar (vendimi për të ndryshuar kushtet e punësimit) nuk ka të bëjë me qëllimin e këtyre organizatave

Fuqia: E ulët ose nuk ekziston pasi çështja për tu vlerësuar (vendimi për të ndryshuar kushtet e punësimit) nuk ka të bëjë me qëllimin e këtyre organizatave.

17. Në vendin A në sektorin e shëndetësisë operojnë 2 spitale kryesorë privat, spitali B dhe spitali C dhe disa spitale të tjerë në përmasa të vogla, të pandikueshëm në treg. Spitali B blen spitalin C.

Vlerësoni nëse Autoriteti i Konkurrencës mund të quhet së është një nga grupet e interesit në transaksionin ndodhur më sipër apo jo. Nëse po, argumentoni rolin dhe një mënyrë të veprimit të Autoritetit të Konkurrencës. Nëse jo, shpjegoni në mënyrë të shtjelluar një nga arsyet.

5 pikë

Përgjigje:

Autoriteti i konkurrencës është një rregullator në treg cili vepron për të siguruar një konkurrencë të lirë dhe efektive, pra është një avokat i konkurrencës dhe interesave të konsumatorit. Duke u nisur nga kjo, autoritetit i konkurrencës është pjesë e grupeve të interesit si rregullator në treg, të cilët mund të ndërhyjnë në treg për të rregulluar kërkesën, ofertën, cmimet, fitimet, cilësinë etj. Nëse spitali B blen spitalin C, tregu shndërrohet në monopol. Në këtë situatë, mënyrat se si Autoriteti i Konkurrencës mund të ndikojë në treg mund të jenë:

- 1- Kontrolli i cmimeve:
Autoriteti i Konkurrencës mund të vendos cmimet maksimale që mund të ofrojë spitali i ri pas blerjes. Si pasojë, cmimet e vendosura nga spitali i ri pas blerjes nuk do të jenë të padrejta për konsumatorët.
- 2- Kontrolli i fitimit Autoriteti i Konkurrencës mund të vendos fitimin maksimal që industria mund të arrijë. Si pasojë, cmimet e vendosura nga spitali i ri pas blerjes nuk do të jenë të padrejta për konsumatorët.
- 3- Promovimin e konkurrencës Duke inkurajuar spitalet e vogla ekzistuese për të konkurruar dhe për të ulur ndikimin e monopolit të krijuar në treg.

18. Nëse ju do të hartoni një kod për qeverisjen e korporatave, çfarë do të merrnit parasysh në lidhje me rëndësinë e përgjegjësisë sociale të korporatave dhe cilat do të ishin disa nga problemet me grupet e interesit në lidhje me përgjegjësinë sociale të korporatave (përmendni minimumi 4 probleme).

5 pikë

Përgjigje:

Përgjegjësia sociale e korporatave rritet me rritjen e korporatës, për shkak të ndikimit të saj në rritje në shoqëri. Gjatë hartimit të një kodi për qeverisjen e korporatave duhet të merren parasysh 4 nivelet e përgjegjësisë sociale dhe balancimi i këtyre përgjegjësisë:

1. Përgjegjësitë ekonomike, që korporatat kanë ndaj aksionarëve, punonjësve, klientëve etj.
2. Përgjegjësitë ligjore, që korporatat jetë në pajtueshëri me ligjet në fuqi.
3. Përgjegjësitë etike, që kërkon që korporatat të veprojnë në një mënyrë të drejtë edhe nëse ligji nuk e kërkon këtë.
4. Përgjegjësitë filantropike, të cilat janë më shumë të dëshiruara sesa të kërkuara.

Disa nga problemet me grupet e interesit:

1. Bashkëpunime me të gjithë grupet e interesit mund të ketë vështirësi manaxhimi, harxhim kohe dhe kushton shume.
2. Mund të jetë e vështirë ose pothuajse e pamundur të arrihet dakordësi mes të gjithë grupeve të interesit.
3. Grupet e interesit mund të jenë të kulturave të ndryshme mes njëri tjetrit, gjë që mund të krijojë problem në interpretimin e veprimeve të ndërmarra nga shoqëria.
4. Mund të ketë probleme të pazgjidhura mes grupeve të interesit dhe shoqërisë, të cilat mund të ndikojnë në çështje të tjera mes tyre.

19. Çfarë kuptoni me “stakeholders”, dhe cili është roli i tyre në qeverisjen e korporatave?

6 pikë

Përgjigje:

Në qeverisjen e korporatave, luan një rol shumë të rëndësishëm teoria e stakeholders (teoria e aktorëve të interesit), e cila ka të bëjë me palët e interesit si: punonjësit, klientët, furnitorët, kreditorët, konkurentët, financierët, grupet politike, grupet shoqërore etj. (2 pikë)

Sipas Edward Freeman, themelues i teorisë së “stakeholders” drejtuesit ekzekutiv dhe manaxherët, krahas kujdesit në realizimin e interesave të aksionarëve dhe raportimit ndaj tyre, duhet të tregojnë vemendje edhe ndaj të drejtave të aktorëve të tjerë të qeverisjes së korporatave si dhe të japin llogari për respektimin e të drejtave të këtyre të fundit. (2 pikë)

Stakeholders, kanë për qëllim të disiplinojnë vendimarrjen e drejtuesve ekzekutiv dhe manaxherëve të korporatave. Nëpërmjet disiplinimit të vendimarrjes, parandalohen veprime në dëm të kapitalit aksionar, aseteve të korporatës, përvetësimin e fondeve, si dhe veprime të tjera si “kostot e agjensisë” (shpenzimet manaxheriale, bonuset e pajustificuara, vendimarrja në interes të përfitimeve personale, etj) (2 pikë)

20. Jepni përkufizimin e “Transparencës” dhe “Drejtësisë” dhe shpjegoni rëndësinë e tyre në sektorin publik.

6 pikë

Përgjigje:

Të qenit **transparent** do të thotë të qenit i hapur dhe dhënien e qartë të informacionit relevant për grupet e interesit, dhe gjithashtu mosfshehja e informacionit që mund të ndikojë vendimet e grupeve të interesit. Informacioni i dhënë duhet të përmbajë detaje të mjaftueshme për të përmbushur pritshmëritë e grupeve të interesit. (1.5 pikë)

Drejtësia është gjithashtu një temë kryesore në sektorin publik. Të jesh i drejtë do të thotë të njohësh interesat e shumta dhe t'i vlerësosh ato kundër të tjerëve në një mënyrë të barabartë dhe transparente. (1.5 pikë)

Sektori publik i detyrohet shumë publikut të gjerë, dhe duhet të jetë i drejtë dhe transparent për të gjitha palët. Për shkak se sektori publik vepron duke përdorur paratë e taksapaguesve, duhet që jo vetëm të jetë i drejtë dhe transparent por edhe të shihet si i tillë, në zbatimin e politikave kombëtare dhe lokale. Jo gjithmonë të gjithë qytetarët dhe problemet trajtohen në mënyrë të barabartë. Meqëse disa interesa duhet të nënvlerësohen për përfitimin më të gjerë të shoqërisë, sektorit publik i duhet të shpjegojë çfarëdo mënyre që përdor për të balancuar interesat e ndryshme të palëve të interesuara mbi të cilat ky sektor ka ndikim. (3 pikë)

Kontrolli i brendshëm, komponentët përbërës dhe organizimi i tij

- 21.** Identifikoni dhe shpjegoni shkurtimisht PESË komponentët e kontrollit të brendshëm të një njësie ekonomike.

5 pikë

Përgjigje:

SNA 315 trajton përgjegjësinë e audituesit për të identifikuar dhe vlerësuar rreziqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare përmes njohjes së entitetit dhe mjedisit të tij, duke përfshirë pesë komponentët e kontrollit të brendshëm të entitetit si më poshtë:

1. Mjedisi i kontrollit

Ky komponent përshkruan kushtet bazë të nevojshme për krijimin e një mjedisi të përshtatshëm kontrolli të brendshëm në një njësi ekonomike të caktuar. Mjedisi i kontrollit i jep tonin njësisë, duke influencuar vetëdijen kontrolluese të njerëzve të saj. Ai përbën themelin ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë duke siguruar disiplinën dhe strukturën. Mjedisi i kontrollit përbëhet nga dy aspekte: strukturat formale dhe aspektet e sjelljes individuale dhe të dy duhet të ndërveprojnë. Menaxhimi ka rolin kyç në miratimin dhe mbështetjen e mjedisit të kontrollit.

Faktorët e mjedisit të kontrollit përfshijnë integritetin, vlerat etike dhe aftësinë e stafit të njësisë; filozofinë e drejtimit dhe stilin e punës; mënyrën sesi menaxhimi cakton përgjegjësi dhe të drejta dhe organizon dhe zhvillon stafin, si dhe përkushtimin dhe orientimet që jep bordi i menaxherëve.

2. Procesi i vlerësimit të rrezikut të entitetit

Për qëllime të raportimit financiar, procesi i vlerësimit të riskut të entitetit përfshin sesi menaxhimi identifikon rreziqet e biznesit lidhur me pasqyrat financiare në përputhje me kuadrin e raportimit financiar të zbatuar nga entiteti. Në këtë proces vlerësohet rëndësia e risqeve si dhe ndikimi i tyre, mundësia e shfaqjes së riskut. Hapi tjetër është marrja e vendimeve nga ana e menaxhimit për reagimin e duhur ndaj riskut.

3. Sistemi informativ i rëndësishëm për raportimin financiar

Sistemi i informacionit lidhet me objektivat e raportimit financiar, i cili përfshin sistemet e kontabilitetit, përbëhet nga procedurat e hartuara dhe të krijuara për të iniciuar, rregjistruar, përpunuar dhe raportuar transaksionet e njësisë (si dhe ngjarjet e kushtet) dhe për të mbajtur kontabilitetin për aktivet përkatëse, detyrimet dhe kapitalin.

4. Aktivitetet e kontrollit të rëndësishme për auditimin

Aktivitetet e kontrollit janë politikat dhe procedurat të cilat sigurojnë se drejtimet e menaxhimit janë ndjekur. Aktivitetet e kontrollit, qoftë brenda teknologjisë së informacionit apo pjesë e sistemeve manuale, kanë të bëjnë me objektiva të ndryshme dhe zbatohen në nivele të ndryshme organizative dhe funksionale.

Audituesit duhet të kenë njohuri rreth aktiviteteve të kontrollit të rëndësishme për auditimin. Mbetet në gjykimin e audituesit njohja e aktiviteteve të kontrollit të cilat janë

të nevojshme për të identifikuar dhe vlerësuar rreziqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare.

5. Monitorimi i kontrolleve

Monitorimi i kontrolleve është procesi nëpërmjet të cilit vlerësohet efektiviteti i performancës së kontrollit të brendshëm përgjatë kohës. Ky proces përfshin vlerësimin e efektivitetit të kontrolleve në mënyrë periodike dhe marrjen e masave të nevojshme për përmirësim.

Menaxhimi e realizon monitorimin e kontrolleve nëpërmjet aktiviteteve të vazhdueshme, vlerësimeve specifike apo kombinimin e këtyre të dyjave. Aktivitetet monitoruese të vazhdueshme janë shpesh herë pjesë e aktiviteteve rutinë të entitetit, të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e përditshëm dhe aktivitetet mbikëqyrëse.

- 22.** Përshkruani KATËR lloje të ndryshme të aktiviteteve të kontrollit dhe, për çdo lloj, jepni një shembull të kontrollit që një kompani mund të zbatojë.

5 pikë

Përgjigje:

Aktivitetet e kontrollit janë politika dhe procedura që ndihmojnë për të siguruar që direktivat e menaxhimit janë zbatuar. Aktivitetet e kontrollit, qofshin nëpërmjet teknologjisë së informacionit ose sisteme manuale, kanë disa objektiva dhe janë të aplikuara në disa organizata dhe nivele funksionesh. Shembuj të aktiviteteve të kontrollit përfshijnë ato të lidhura me sa më poshtë:

1. Kontrolli i programeve
2. Kontrollat e përgjithshme të sistemeve të TI
3. Rishikimin e performancës
4. Ndarjen e detyrave

Kontrolli i programeve, i cili zbatohet në përpunimin e programeve individuale. Shembuj të kontrolleve të programeve përfshijnë kontrollin mbi saktësinë matematikore të regjistrimeve, duke mbajtur dhe rishikuar llogaritë dhe bilancin vërtetues, kontrollet e automatizuara të tilla si paraqitja e kontrolleve të hyrjes së të dhënave dhe kontrolli i rrjedhës kronologjike, dhe ndjekja në mënyrë manuale e raporteve përjashtuese.

Kontrollet e përgjithshme të sistemeve TI, të cilët janë politika dhe procedura që lidhen me shumë programe, si dhe mbështesin funksionimin në mënyrë efektive të kontrolleve të programeve duke ndihmuar që të sigurohet funksionimi në vazhdimësi dhe si duhet i sistemeve të informacionit. Shembuj të kontrolleve të përgjithshme të sistemeve TI janë kontrolli i ndryshimit të programeve, kontrolli që kufizon të drejtën e hyrjes në të dhënat ose mbi programet, kontrolli mbi zbatimin e elementeve të reja të programeve të paketave të softëare-ve, dhe kontrollin mbi sistemin e softëare-ve që kufizon të drejtën për të hyrë, vëzhguar ose përdorur pajisjet e sistemit me anën e të cilave mund të ndryshohen të dhënat financiare ose regjistrimet pa lënë gjurmë auditimi.

Rishikimii performancës ka të bëjë më vendosjen e kontroleve/procedurës së përshatshme për matjen e performancës në mënyrë periodike të njësisë. Performanca mund të matet nëpërmjet matjes së indikatorëve të synuar për tu arritur nga njësia në një afat kohor të caktuar.

Ndarja e detyrave brenda njësisë mund të realizohet nëpërmjet hartimit të përshkrimeve të qarta të punës për të gjitha pozicionet.

- 23. Çfarë kuptojmë me monitorim dhe cilat janë konsideratat në lidhje me këtë komponent për entitetet e vogla?**

5 pikë

Përgjigje:

Monitorimi i kontrollit është një proces që akseson në efektivitetin e performancës së kontrollit të brendshëm gjatë kohës. Përfshin vlerësimin efektivitetin e kontrollit në bazë të kohës dhe të ndërrmeren veprime rregulluese. Manaxhimi arrin të monitorojë kontrollin nëpërmjet aktiviteteve të vazhdueshme, vlerësimeve të ndara, ose kombinim i të dyjave. Monitorimi i vazhdueshëm i aktiviteteve shpesh ndërtohet në aktivitete normale të një entiteti dhe përfshijnë manaxhimin e rregullt edhe aktivitete supervizimi.

Aktivitetet manaxheriale të monitorimit mund të përfshijnë forma komunikimi nga palët e treta si klientët e bindur, dhe vërejtje rregulluese që mund të shfaqin probleme ose zona që kanë nevojë për përmirësim.

Konsiderata specifike për Entitetet e vogla

Monitorimi i aktiviteteve nga ana e menaxhimit kryhet shpesh nga përfshirja e ngushtë e pronarit menaxher ose e menaxhimit në operacionet. Kjo përfshirje do të identifikojë variance nga parashikimet dhe pasaktësitë në të dhënat financiare që do të cojnë në veprime rregulluese për kontrollin.

- 24. Rast studimor lidhur me mjedisin e kontrollit në Fondacionin X.**

Fondacioni X u krijua në vitin 1960. Qëllimi i këtij fondacioni është të sigurojë mbështetje për fëmijët në nevojë, të cilët dëshirojnë të marrin pjesë në sporte të tilla si: tenisi dhe futboli.

Fondacioni X ka një statut të detajuar, i cili shpjegon se si mund të shpenzohen të ardhurat e bamirësisë. Statuti gjithashtu vë në dukje se shpenzimet e administratës nuk mund të kalojnë 10% të të ardhurave në çdo vit.

Të ardhurat e bamirësisë rrjedhin tërësisht nga donacionet vullnetare. Burimet e donacioneve përfshijnë:

(i) Paratë e grumbulluara nga vullnetarët që kërkojnë nga publiku donacione në qendrat tregtare;

(ii) Ceqe të dërguara në zyrën qendrore të fondacionit;

(iii) Donacione nga individë bujarë. Disa prej këtyre donacioneve kanë klauzola specifike që i bashkëngjiten atyre duke treguar se shumat fillestare e dhuruar (kapitalit) nuk mund

të shpenzohet dhe se të ardhurat (interesat) nga donacioni duhet të shpenzohen për aktivitete specifike, për shembull, sigurimi i pajisjeve sportive.

Rregullat lidhur me tatimin e bamirësisë në vendin e Fondacionit X janë të komplikuar, ku vetëm disa shpenzime përjashtohen për qëllime tatimore dhe donacione të kapitalit trajtohen si të ardhura në disa situata.

Shpjegoni pse Fondacioni X mund të ketë një mjedis kontrolli të dobët?

6 pikë

Përgjigje:

Mjedisi i dobët i kontrollit në Fondacionin X mund të rrjedhojë për shkak të:

1. Mungesës së ndarjes së detyrave/përgjegjësie

Në këto lloj Fondacionesh zakonisht numri i stafit është relativisht i vogël, çka nënkupton që një sistem i plotë i kontrollit të brendshëm duke përfshirë ndarjen e qartë të detyrave nuk mund të zbatohet në këtë njësi. Ekziston mundësia që stafi të mos jetë i qartë për detyrat respektive (mungesa e përfshirjeve të punës), si dhe një pjesë e stafit mund të mos jenë pjesë e strukturës formale organizative.

2. Stafit vullnetar

Një pjesë e stafit përfshihen vullnetarisht çka do të thotë që ata punojnë në fondacion rast pas rasti. Në këtë mënyrë kontrollet do të zbatohen nga staf i ndryshëm në ditë të ndryshme duke e bërë sistemin jo të besueshëm.

3. Mungesa e stafit të kualifikuar (çështje të burimeve njerëzore)

Përzgjedhja e stafit në Fondacion është e kufizuar. Njerëzit përfshihen në punë vullnetare kur ata kanë kohë. Për këtë arsye stafi vullnetar në Fondacion mund të mos ketë kualifikimin profesional dhe eksperiencën e duhur për të zbatuar dhe mbajtur një sistem kontrolli të përshtatshëm.

4. Mungesa e një departamenti të auditimit (mungesa e strukture organizative)

Një sistem kontrolli nuk mund të monitorohet në mënyrë efektive, në rastin e mungesës së një departamenti të auditimit. Fondacioni nuk ka mundësi financiare apo eksperiencën e duhur për të krijuar një departament të tillë.

5. Qëndrimi i administrimit

Në rastet kur administratorët nuk janë të trajnuar profesionalisht apo kanë shumë pak kohë për t'ju përkushtuar fondacionit, atëherë krijohet përshtypja që kontrollet nuk janë të rëndësishme. Për rrjedhojë mjedisi i kontrollit mund të jetë i dobët dhe pjesa tjetër e stafit të fondacionit nuk e kuptojnë rëndësinë e kontrolleve të duhura, për të cilat duhet të informohen nga ana e administratorit.

25. Ku konsiston sistemi i informacionit i rëndësishëm për objektivat e raportimit financiar, që përfshijnë sistemet e kontabilitetit?

6 pikë

Përgjigje:

Sistemi i informacionit i rëndësishëm për objektivat e raportimit financiar, që përfshin sistemet e kontabilitetit, konsiston në:

- a. Proçedurat dhe regjistrimet e hartuara e themeluar për të ndërmarrë, regjistruar, proçesuar, dhe raportuar transaksionet e entitetit (ashtu si ngjarjet dhe kushtet) dhe për të mbajtur kontabilitetin e aseteve, detyrimeve dhe kapitalit.
- b. Zgjidhje e proçesimit inkorrekt të transaksioneve, si për shembull, pezullimi automatik i skedarëve dhe proçedura që ndiqen për të pastruar këto skedarë të pezulluar në kohë.
- c. Proçese dhe llogari për kontrollin e shkeljes së sistemeve.
- d. Transferimi i informacionit nga sistemet e proçesimit tek logaritë e librit të madh.
- e. Kapja e informacionit financiar të rëndësishëm për ngjarjet dhe kushtet më shumë sesa për transaksionet, si zhvlerësimi dhe amortizimi i aseteve dhe ndryshimi në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme.
- f. Sigurimi i informacionit të kërkuar për tu zbuluar nga korniza e raportimit.

Seksioni V

Sistemet e informatikës dhe të kompjuterave

26. Përshkruani përfitimet e biznesit që lidhen me zhvillimin e suksesshëm të programeve kompjuterike.

4 pikë

Përgjigje:

Zhvillimi i çdo softueri përdor ciklin e jetës së zhvillimit të sistemeve për të krijuar programe kompjuterike, cikël i cili nis me një nevojë biznesi, vazhdon me vlerësimin e funksioneve që duhet të ketë sistemi për të përmbushur këtë nevojë biznesi, dhe përfundon kur përfitimet e sistemit nuk tejkalojnë kostot e mirëmbajtjes. Përfitimet që lidhen me zhvillimin e suksesshëm të softuerëve përfshijnë rritjen e të ardhurave dhe të produktivitetit të kompanisë, si edhe rimëkëmbjen e reputacionit të markës pas një eventi negativ, apo përgjegjësitë e kufizuara.

27. Cili është dallimi mes një software kontabiliteti dhe një software të ndërmarrjes?

5 pikë

Përgjigje:

Software-t kontabël janë në thelb programe që përpunojnë të gjitha transaksionet kontabël. Ato organizohen në module: moduli i shitjeve, blerjeve apo libri i madh. Në varësi të sofistikimit të tyre, software-t kontabël mund të kenë edhe module të tjera si listëpagesa, aktivet afatgjata, etj.

Meqës software-t e thjeshtë (**low-end**) destinohen për njësi ekonomike të vogla, ku në fokus është informacioni për fitimin dhe fluksete mjeteve monetare, edhe outputi përqëndrohet kryesisht në raporte të tilla si: raporti për faturat e prapambetura, raporti për klientë të vonuar apo raporte për lëvizjet e mjeteve monetare në arkë / bankë. Fakti që quhen software kontabël të thjeshtë nuk nënkupton që nuk kanë kompleksitet në përpunimin e informacionit kontabël, por që kanë tipare të limituara dhe suportojnë një numër të kufizuar regjistrimesh në ditë.

Kur aktiviteti i njësisë rritet, atëherë njësia ekonomike është rasti të investojë në një software më të sofistikuar (**mid-range**). Këta software ofrojnë mundësinë e përpunimit të më shumë transaksioneve si për shembull përpunimin e transaksioneve në shumë monedha, apo ndarjen e komisioneve të shitjes mes disa agjentëve, etj. Njësia ekonomike ka mundësinë që për këta software të zgjedhë të blejë modulet të cilat i shërbejnë asaj. Pra këto softe ndërtohen në module të veçanta në mënyrë që të bëhet blerje sipas nevojës për secilin modul. Kjo mundësi lehtëson koston e softit. Në rast se njësia ekonomike ka nevojë për module shumë komplekse dhe të avancuara atëherë ajo investon në një software kontabël (**high-end**) i cili ka një kosto shumë të lartë por përbëhet nga module shumë të specializuara dhe të integruara.

Por sistemet e informacionit në njësinë ekonomike duhet të mundësojnë më shumë sesa vetëm regjistrimin e transaksioneve kontabël. Ato duhet të japin informacionin për të gjithë njësinë ekonomike, sektorët dhe departamentet e saj. Prej dy dekadash është zhvilluar koncepti i **software të ndërmarrjes Enterprise Resources Planning (ERP)**. Tipare dalluese të këtyre software-ve janë integrimi i funksionit kontabël me funksionet e tjera të prodhimit, marketingut, burimeve njerëzore, si dhe një bazë të dhënash qendrore. Kosto e tyre nuk është efektive në njësitë ekonomike të vogla por është mëse i justifikuar në njësitë ekonomike të mëdha.

Sistemet ERP kanë një fuksionalitet të tillë që përballojnë çdo lloj kuadri të raportimit financiar, funksionojnë për çdo sektor dhe nuk ndikohen nga ndryshimet rajonale.

Tiparet kryesore të ERP janë:

1. Përbëhen nga shumë module - për çdo funksion të njësisë ekonomike (prodhimi, shitja, shpërndarja, etj)
2. Aplikacione të integruara – të cilat së bashku shërbejnë për të transmetuar transaksionet individuale në të gjithë procesin e biznesit. Kjo sjellje modulare jep fleksibilitet dhe bën të mundur që ndërfaqet e programit të ndërveprojnë me

njëra tjetrën. Një transaksion manual i vetëm sinjalizon nisjen e transaksioneve automatike në aplikacione të tjera.

3. Përpunimi i transaksioneve në ERP bëhet zakonisht në kohë reale, pra çdo transaksion individual ngarkohet në sistem menjëherë dhe azhuron statusin e elementeve të tjerë.
4. ERP janë shumë komplekse, sa më shumë aplikacione aq më komplekse është situata. Janë mijra konfigurime dhe parametra që ndërveprojnë me njëri tjetrin.
5. Sistemet ERP mbështeten në depozitimin e të dhënave në baza të dhënash relacionale shumë masive.

Sistemet ERP të zgjeruara:

- a) mund të integrohen me modulin e klientëve dhe furnitorëve (Supply Chain Management)
- b) mund të zgjerohen me modulin e menaxhimit të lidhjeve me klientët (Customer Relationship Management)
- c) mund të zgjerohen me sistemet e planifikimit dhe skedulimit të avancuar (Advanced Planning and Scheduling Systems)

Klodian Mene

Kryetar

Komisioni i Provimeve të Aftësive Profesionale